Grant Thornton

**Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.**
**RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL**
**Mbi Pasqyrat Financiare të Riformuara dhe**
**Pasqyra e Ilogaritjeve të kapitalit**
**Për qëllim të zmadhimit të kapitalit themeltar**

## I. Qëllimi i Angazhimit

Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a. (në vijim shkurtimisht "Shoqëria") ka kërkuar nga Shoqëria "Grant Thornton" SHPK, Tiranë, Shqipëri (në vijim shkrutimisht "Grant Thornton","ne", "Eksperti Kontabël") si Ekspert Kontabël për të verifikuar dhe për të kontrolluar përgatitjen dhe paraqitjen me vërtetësi të shumave dhe mundësive të zmadhimit të kapitalit duke përdorur si burim kontributin e aksionarëve në mjete likuide.

## II. Kriteret

Si bazë për angazhimin e verifikimit të mundësisë për zmadhimin e kapitalit, ne kemi përdorur Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, Ligjin Nr.25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", Ligjin nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Ne jemi njohur me Vendimin e Asamblesë së Shoqërisë për zmadhimin e kapitalit datë 07/06/2023, por nuk kemi verifikuar në mënyrë të pavarur përputhshmërinë e tij me parashikimet e ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, duke qenë jashtë angazhimit sipas qëllimit të punës së Ekspertit Kontabël, përcaktuar në kreun V më poshtë.

Ne jemi njohur dhe kemi verifikuar dokumentin e pranimit nga ana e aksionarit/ëve për shumat e kontributit të pranuara gjatë fazës së dytë për qëllim të zmadhimit të kapitalit.

## III. Përgjegjësia e Drejtues-it/ve të Shoqërisë

Drejtuesi/t e Shoqërisë është/janë përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e saktë dhe të vërtetë të pasqyrave financiare në përputhje me kriteret e sipërpërmendura. Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e saktë dhe të vërtetë të pasqyrave financiare, të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat financiare.

Drejtuesi/t e Shoqërisë është/janë përgjegjës për respektimin e të drejtave të aksionarëve dhe kryerjen e llogaritjes së drejtë të numrit të aksioneve që i takojnë aksionarëve të Shoqërisë në momentin e zmadhimit të kapitalit. Drejtuesi/t e Shoqërisë është/janë përgjegjës për respektimin e parashikimeve dhe modaliteteve ligjore dhe statutore për thirrjen e asamblesë me rend dite zmadhimin e kapitalit dhe përputhshmërinë e vendimit për zmadhimin e kapitalit me parashikimet e ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

## IV. Përgjegjësia jonë

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në procedurat e kryera, të shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare të përgatitura për këtë qëllim. Opinioni ynë bazohet mbi informacionet e përgatitura nga drejtimi i Shoqërisë për kapitalet e veta, duke konsideruar që këto informacione janë të vërteta dhe të vlefshme, në të gjitha aspektet materiale, si dhe financimet e kryera nga aksionarët mund të përdoren për qëllim të zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë.

## V. Procedurat e kryera

Procedurat e kryera nga ana jonë për këtë angazhim përfshijnë:

1. Verifikimin e përputhshmërisë së shifrave në pasqyrën e Kapitaleve të Veta me ato të Pasqyrave financiare.
2. Verifikimin e kontributit të pranuar nga aksionari/ët gjatë fazës së dytë të ofertimit për këtë qëllim deri më 21/08/2023.
3. Verifikimin e llogaritjeve për vlerën nominale dhe numrin e aksioneve si efekt i zmadhimit të kapitalit themeltar.
4. Verifikimin e llogaritjeve të vlerës që lind nga diferenca e vlerës nominale prej 15.51 USD/aksion dhe çmimit të shitjes të përcaktuar nga asambleja e aksionarëve prej 8 USD/aksion.
5. Verifikimin e llogaritjeve për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë dhe përthithjen e humbjes lindur nga diferenca midis vlerës nominale të aksionit dhe çmimit të blerjes së aksionit.
6. Të tjera çështje që vlerësohen të rëndësishme për qëllim të zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë.

## VI. Konkluzioni

**1.** Bazuar në procedurat e kryera, shuma e kapitalit themeltar ekzistues deri më datën 20 gusht 2023 është 2,760,314,269 Lekë. Këto shuma rakordojnë me llogaritë përkatëse dhe dokumentacionin mbështetës që ne verifikuam.

**2.** Vlera e kapitalit që do të paguhet është 2,003,528.53 Euro dhe numri i aksioneve të emetuar 271,594 aksione. Në bazë të vendimit datë 7 qershor 2023 kurset e këmbimit që do të përdoren do të jenë ato të datës 30 qershor 2023 të publikuara nga Banka e Shqipërisë:

a) EUR 106.44
b) USD 98.15

Pasqyra e llogaritjeve për qëllim të zmadhimit të kapitalit themeltar përgatitur nga menaxhimi i Shoqërisë paraqet me vërtetësi vlerën nominale të aksioneve të emetuara prej 4,212,707 USD e këmbyer në 413,477,231 Lekë.

**3.** Pasqyra e llogaritjeve të zmadhimit të kapitalit themeltar përgatitur nga Drejtuesi/t e Shoqërisë në vlerën prej 2,039,956 USD e këmbyer në Lekë 200,221,654 Lekë përfaqëson diferencën midis vlerës nominale dhe çmimit të blerjes së aksioneve të emetuara.

**4.** Pasqyra e llogaritjeve për qëllim të zmadhimit të kapitalit themeltar përgatitur nga menaxhimi i Shoqërisë paraqet me vërtetësi vlerën e re nominale të aksioneve në shumën 14.33 USD/aksion si rrjedhojë e përthithjes së diferencës midis ndryshimit të vlerës nominale për aksion dhe çmimit të blerjes prej 8 USD/aksion.

**5**. Në bazë të dokumentave të dërguara nga aksionarët e Shoqërisë (në anekset bashkangjitur) pasqyra e llogaritjeve për qëllim të zmadhimit të kapitalit themeltar përgatitur nga menaxhimi i Shoqërisë paraqet me vërtetësi numrin dhe vlerën e aksioneve të pranuara nga secili aksionar dhe respektivisht:

| Aksionari | Numri i aksioneve të pranuara | Vlera nominale e aksioneve në USD | Vlera nominale e aksioneve në Lekë |
|---|---|---|---|
| Eurosig Sh.a | 271,594 | 4,212,707 | 413,477,231 |
| **Totali** | **271,594** | 4,212,707 | **413,477,231** |

Në vijim të konfirmimit të pagesës së kapitalit të ri të emetuar datë 21 gusht 2023, kapitali themeltar i Shoqërisë dhe numri i aksioneve bëhet si më poshtë:

a) Kapitali themeltar i Bankës së Bashkuar të Shqipërisë nga 22,631,987 USD ose 2,760,314,269 Lekë rritet edhe me 2,172,752 USD ose 213,255,577 Lekë dhe bëhet 24,804,739 USD ose 2,973,569,845 Lekë. Numri i aksioneve dhe vlera nominale për çdo aksion mbas përfundimit të operacionit të rritjes së kapitalit do të shkojë nga 1,459,088 aksione në 1,730,682 aksione (duke u rritur me 271,594 aksione) dhe vlera nominale për aksion nga 15.51 USD/aksion ose në 1,891.81 Lekë/aksion bëhet 14.33 USD/aksion ose 1,718.15 Lekë/aksion.

b) Mbas përfundimit të operacionit të rritjes së kapitalit zotërimi i aksioneve në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë do të jetë si në vijim:

| Aksionarët | Numri i aksioneve | Vlera në USD | % e aksioneve | Vlera nominale për aksion në USD |
|---|---|---|---|---|
| Islamic Development Bank | 248,613 | 3,563,208 | 14.37% | 14.33 |
| EUROSIG SH.A. | 1,467,486 | 21,032,522 | 84.79% | 14.33 |
| Saudi Brothers Commercial Co. | 3,168 | 45,405 | 0.18% | 14.33 |
| Hamed H. Mutabakani | 9,306 | 133,377 | 0.54% | 14.33 |
| Hayder Mohamad Awad | 1,267 | 18,159 | 0.07% | 14.33 |
| Faisal A. El Khereiji | 842 | 12,068 | 0.05% | 14.33 |
| **Totali** | **1,730,682** | **24,804,739** | **100%** | **14.33** |

**Kufizime në shpërndarje**

Pasqyrat bashkëngjitur janë përgatitur për qëllime të certifikimit të rritjes së kapitalit themeltar dhe nuk kërkohen si pjesë e pasqyrave financiare për qëllime ligjore. Ky raport është vetëm për qëllimin e zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë dhe nuk duhet përdorur për ndonjë qëllim tjetër.

Tiranë më datë 21 gusht 2023

Grant Thornton SHPK

Eksperti Kontabël

Dr. Kledian Kodra, FCCA

**SIMULIM:RRITJE KAPITALI UBA BANK 100% NGA : EUROSIG SHA + 2.003 MLN EUR** *Sot :21 gusht 2023*

**Seksioni C: Llogaritja e aksioneve të reja**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Vlera e kapitalit që do te rritet ne EURO | 2,003,528.53 | | |
| Kursi i kembimit nga BSH ne 30.6.2023 | 106.44 | *Sipas Vendim GA te mbajtur 7.6.2023,me KK te datës së transaksionit* | 98.15 ALL/USD |
| Vlera e kapitalit që do te rritet ne ALL | 213,255,576.60 | | |
| Vlera nominale e aksionit | 1,891.81 | | |
| Çmimi i pranuar për aksionet e reja ne USD | 8.00 USD | | |
| Çmimi ekuivalent për aksionet e reja ne Lekë | 785.20 Leke | | |
| Primi për aksion | (1,106.61) | | |
| **Numri i aksioneve që do të emetohen** | **271,594** | | |
| **Vlera nominale e aksioneve** | **513,803,595** | | |
| Primi negativ | (300,548,018) | | |
| | 213,255,577 | | |

| | Aksione | Çmim/Aksion | Vlera | Aksione | Çmim/Aksion | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Aksionet ekzistuese | 1,459,088 | 1,891.81 | 2,760,314,269 | 1,459,088 | 15.51 | 22,631,987 |
| Aksionet e reja | 271,594 | 785.20 | 213,255,577 | 271,594 | 8.00 | 2,172,752 |
| Totali i aksioneve | 1,730,682 | 1,718.15 | 2,973,569,845 | 1,730,682 | 14.33 | 24,804,739 |

**Seksioni D1: Struktura e pronësisë së aksioneve pas rritjes së kapitalit**

| Emri i Aksionarit | Numri i Aksioneve | Çmimi | Kapitali i Paguar | Perqindja e Pjesemarrjes | Kapitali i Paguar | Aksionet e reja që do të emetohen | Numri i Aksioneve | Çmimi | Kapitali i Paguar | Perqindja e Pjesemarrjes | Perthithja e primit negativ | Kapitali i Paguar | Perqindja e Pjesëmarrjes | Vlera Nominale | Vlera Nominale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | në Lekë | në Leke | | në USD | | | në Lekë | në Lekë | | | në Lekë | | në Lekë | në USD |
| Islamic Development Bank | 248,613 | 1,891.81 | 470,328,035 | 17.04% | 3,856,249 | | 248,613 | 1,891.81 | 470,328,035 | 14.37% | (43,173,815) | 427,154,220 | 14.37% | 1,718.15 | 3,563,208 |
| EUROSIG SH.A. | 1,195,892 | 1,891.81 | 2,262,397,999 | 81.96% | 18,549,541 | 271,594 | 1,467,486 | 1,891.81 | 2,776,201,594 | 84.79% | (254,841,738) | 2,521,359,856 | 84.79% | 1,718.15 | 21,032,522 |
| Saudi Brothers Commercial Co. | 3,168 | 1,891.81 | 5,993,247 | 0.22% | 49,139 | | 3,168 | 1,891.81 | 5,993,247 | 0.18% | (550,151) | 5,443,097 | 0.18% | 1,718.15 | 45,405 |
| Hamed H. Mutabakani | 9,306 | 1,891.81 | 17,605,164 | 0.64% | 144,346 | | 9,306 | 1,891.81 | 17,605,164 | 0.54% | (1,616,068) | 15,989,096 | 0.54% | 1,718.15 | 133,377 |
| Hayder Mohamad Awad | 1,267 | 1,891.81 | 2,396,921 | 0.09% | 19,652 | | 1,267 | 1,891.81 | 2,396,921 | 0.07% | (220,026) | 2,176,895 | 0.07% | 1,718.15 | 18,159 |
| Faisal A. El Khereiji | 842 | 1,891.81 | 1,592,902 | 0.06% | 13,060 | | 842 | 1,891.81 | 1,592,902 | 0.05% | (146,221) | 1,446,682 | 0.05% | 1,718.15 | 12,068 |
| TOTALI | 1,459,088 | 1,891.81 | 2,760,314,269 | 100.00% | 22,631,987 | | 1,730,682 | | 3,274,117,863 | 100.00% | (300,548,018) | 2,973,569,845 | 100.00% | 1,718.15 | 24,804,739 |
| Primi negativ për kapitalin | (300,548,018) | | | | | | 2,973,569,845 | | (300,548,018) | | | | | | |
| TOTALI | 1,459,088 | | 2,760,314,269 | 100.00% | 22,631,987 | | 2,973,569,845 | | 2,973,569,845 | 100.00% | | | | | |